



**REPUBLIKA E KOSOVËS**



**KOMUNA VUSHTRRI**

**Drejtoria për Shërbime Publike**

**11 nr. 03/16**

**01.02.2016**

Duke u bazuar në **Nenin 6** të **Ligjit për Transportin Rrugor**, përmes të cilit përcaktohen kompetencat e komunës në sektorin e transportit, si dhe në **Nenin 4** të **Rregullores për transportin rrugor në territorin e Komunës së Vushtrrisë**, Drejtoria për Shërbime Publike shpall:

## **K O N K U R S**

Për ndarjen e linjave urbano-periferike dhe rrendeve të udhëtimit për transportin e udhëtarëve me autobusë, për vitin 2016 në këto relacione:

1. Vushtrri – Zhilivodë
2. Vushtrri - Stroc
3. Vushtrri - Mihaliq
4. Vushtrri - Shallc
5. Vushtrri - Duboc – Beqiq
6. Vushtrri – Ashlan
7. Vushtrri – Balinc
8. Vushtrri – Sllakoc
9. Vushtrri – Dumnicë e Epërme
10. Vushtrri – Stanoc i Poshtëm
11. Vushtrri – Studime e Epërme
12. Vushtrri – Karaqë
13. Vushtrri – Smrekonicë – Pasomë

Operatori transportues **për një relacion** mund të konkurrojë vetëm për **një Rend të Udhëtimit**.

Operatori transportues, për të konkuruar në konkursin për transportin urban – periferik të udhëtarëve duhet plotësuar këto **kritere**:

1. **Operatori transportues duhet të jetë i licencuar**
2. **Dëshminë për kryerjen e obligimeve tatimore ndaj Kuvendit Komunal**
3. **Operatori i transportit paraprakisht përcakton çmimoren, e cila duhet të jetë e vendosur në autobusin që qarkullon në atë linjë, prandaj merr pagesën për shërbime, vetëm në bazë të asaj çmimoreje.**
4. **Rendi i udhëtimit mund të merret vetëm nga personi përgjegjës i firmës që konkurron.**
5. **„Rendi i udhëtimit”, i cili përmban llojin e linjës, korridorin në të cilin kryhet transporti, renditjen e stacioneve të autobusëve apo vendbanimeve, kohën e nisjes dhe arritjes nga stacionet e autobusëve gjegjësisht nga vendbanimet, si dhe afatin e vlefshmërisë, është i përpiluar nga Organi Kompetent Komunal.**

**Dorëzimi i dokumentacionit të kompletuar, bëhet në adresë të Drejtorisë për Shërbime Publike, brenda 15 ditësh nga dita e shpalljes.**